



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr.14, datë 30.10.2025

PËR

REVOKIMIN E LEJES/AUTORIZIMIT, LIDHUR ME REVOKIMIN E LEJES
NR. SERIAL 000025 “LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR UJITJE”,
TË SUBJEKTIT “WINE.AL” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Seman,

V E N D O S I:

1. Revokimin e lejes/autorizimit, lidhur me revokimin e lejes Nr. Serial 000025 “Leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje”, të subjektit “Wine.Al” sh.p.k, me vendndodhje: Bashkia Berat, Qarku Berat.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SEMAN

ANDUEL XHINDI

